



Datë: 20.02.2025  
Numër Potokolli: 1635/2025

A.nr.2079/2024

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, -kryetare; Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani, anëtare, me Ylber Fetahaj, , në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2079/2024, të datës 23.12.2024, të parashtruar nga ankuesja V.L kundër Njoftimit të datës 12.11.2024 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.02.2025, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar** ankesa me numër A.nr.2079/2024, e datës 23.12.2024, e parashtruar nga ankuesja, V.L.
- II. Mbetet në fuqi** Njoftimi i datës 12.11.2024 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Njoftimi i datës 06.12.2024 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve, për pozitën e punës „*Zyrtar për Shërbime të Punësimit 2*” me numër reference RN00015107 në Zyrën e Punësimit në Hanin e Elezit në Agjencinë e Punësimit në Kosovë

## A r s y e t i m

Kandidatja për praninë në shërbim civil, V.L (në tekstin e mëtejshme referuar: Ankuesja), më datë 23.12.2024, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7005/2024, të regjistruar nën shenjën A.nr.2079/2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 12.11.2024 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/Agjencia e Punësimit, me të cilin vendim ankueses i është refuzuar aplikacioni për procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00015107 për grupin “*Grupi i Shkencave Shoqërore*” gjegjësisht pozitën e punës “*Zyrtar për Shërbime të Punësimit*” në Zyrën e Punësimit në Hanin e Elezit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 20.01.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7005/2024 të parashtruar më datë 23.12.2024 në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00015107 të datës 13.09.2024; vërtetimin e praktikës e datës 25.11.2022; kopjen e letërnjoftimit të ankuese; përgjigje ne ankesë të datës 20.01.2025; listën e aplikanteve; listën a konditave të aprovuar dhe listën e kandidatëve të refuzuar; vendimin e datës 28.10.2024 për vazhdimin e afatit të verifikimit paraprak; njoftimin e datës 12.11.2024; vendimin e datës 17.09.2024 për themelimin e komisionit të pranimit; Akt Emërimit e datës 23.10.2023; Akt Emërimit e datës 06.09.2019; Akt Emërimit e datës 14.08.2023; Akt Emërimit e datës 30.03.2023; Akt Emërimit e datës 28.12.2017; Aplikacionin e datës 12.10.2024 të ankuese V.S-L të bashkangjitur me gjitha dokumentet e aplikimit; Aplikacionin e datës 10.10.2024 të kandidatës fituese A.B të bashkangjitur me gjitha dokumentet e aplikimit; testin me shkrim të A. B. formularët e vlerësimit individual nga anëtarët e komisionit për kandidatet fituese A.B; Njoftimin e datës 06.12.2024 për kandidaten fituese; Listën Përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve; Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve e datës 06.12.2024; njoftimin e datës 12.11.2024 për refuzimi e aplikacionit të ankuses V.L;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pa bazuar, **sepse:**

Nga analizimi i provave të lëndës rezulton se më datë 13.09.2024 është shpallur Konkurs publik për grupin “Grupi i Shkencave Shoqërore”, respektivisht pozitën e punës “Zyrtar për Shërbime të Punësimit 2” në Zyrën e Punësimit në Komunën e Hanit të Elezit me numër të referencës RN00015107 ku afati për aplikim ka qenë nga data 14.09.2024 deri më 13.10.2024. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, ku më datë 12.11.2024 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, i është refuzuar, aplikacioni për shkak mos plotësimit të kriteret e konkursit gjegjësisht ankuesja nuk e ka dorëzuar dëshminë e kërkuar sipas konkursit se ajo nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi **për shkëlje të rëndë në institucion publik.**

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër Njoftimit të datës 12.11.2024 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencia e Punësimit në Republikën së Kosovës, pretendon se nuk e ka bashkangjitur dëshminë për masë disiplinore pasi që e njëjta nuk ka qenë asnjëherë e punësuar në institucion publik, tutje ankuesja thekson faktin se ka përfunduar praktikën (5) mujore në institucione publike mirëpo nuk ka pasur ndonjë masë disiplinore në fuqi.

Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin me numër të referencës RN00015107 për emrin e grupit „Grupi i Shkencave Shoqërore”, respektivisht për pozitën e punës “Zyrtar për Shërbime të Punësimit 2” në Zyrën e Punësimit në Hanin e Elezit kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor ) në fushën Juridik, Ekonomik, (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Pune Sociale, Gjeografi apo Administrate Publike;
- **Përvoja e punës:** Se paku një (1) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.

Kolegji i Këshillit në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuses, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohej se: 1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë

veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njëzë nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; **1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;** 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohej se: 2. *Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Po ashtu, nga analizimi i Konkursit me numër reference RN00015107 për grupin “Grupi i shkencave shoqërore” gjegjësisht pozitën e punës “Zyrtar për Shërbime të Punësimit 2” në Agjencinë e Punësimit në Kosovë në Zyrën e Punësimit të Hanit të Elezit. Kolegji ka gjetur se të gjithë kandidatet kanë qenë të njoftuar lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, duke përfshi këtu: *Kopjen e letërnjoftimit; Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; Kopjet e dëshmisë së punësimit lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë (vërtetim/kontratë); Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (kandidatët që janë të punësuar apo që kanë qenë të punësuar në institucione publike)*, ndërsa edhe përkundër kësaj, ankuesja nuk ka mundur të vërtetoj me asnjë provë se e njëjta me rastin e aplikimit ka dorëzuar dokumentin, gjegjësisht vërtetimin e lëshuar nga institucioni ku ka punuar si Praktikante që dëshmon se për periudhën që ka punuar nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi, dhe se mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar.

Kolegji i Këshillit, po ashtu, në kontekst të vlerësimit të procedurës përkatëse të rekrutimit ka shqyrtuar dhe analizuar edhe dosjen e kandidatës fitues A.B, nga analizimi i te cilës ka gjetur se e njëjta posedon Diplomën me numër 7413, të lëshuar me datë 11.03.2021 nga Universiteti i Prishtinës, Hasan Prishtina”, me te cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik me date 12.02.2021 dhe ka marr titullin „Jurist i diplomuar”-Baçelor, me te cilën dëshmohet se e njëjta ka plotësuar kriterin e kualifikimit arsimor për pozitën e shpallur. Ndërsa lidhur me përvojën e punës pas diplomimit, e njëjta me rastin e aplikimit ka dorëzuar Marrëveshje për Angazhim për Pune Praktike ne Sektorin Publik me numër protokolli 88/22 të datës 05.07.2022 te lidhur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe kandidatja A.B, me te cilën dëshmohet se e njëjta është angazhuar si Praktikante ne Zyrën e Punësimit ne Hanin e Elezit për 6 muaj gjegjësisht nga data 05.07.2022 deri me 05.01.2023 si dhe Vazhdimi i Marrëveshjes për Praktikë ne Pune e datës 10.01.2023 me te cilën dëshmohet se kandidatja A.B ka vazhduar praktiken në Zyrën e Punësimit ne Hanin e Elezit edhe për 6 muaj nga data 06.01.2023 deri me date 30.06.2023; Vërtetimin e datës 26.04.2024 te lëshuar nga Qendra Rajonale e Pensioneve Ferizaj – Departamenti i Pensioneve- MFPT që nuk ka mase disiplinore ne fuqi, Certifikatën e datës 19.09.2024 te lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës përmes se cilës dëshmohet se nuk është e dënuar me aktgjykim te formës se prerë, andaj mbi bazën e këtyre dëshmive rrjedhë së kandidatja A.B, ka plotësuar kriteret siç është përcaktuar me konkursin me numër reference RN00015107. Andaj, duke qenë së kandidatja A.B në fund të procedurës se vlerësimit ka arritur gjithsej 82.8 pike te përgjithshme, atëherë edhe

Komisioni i pranimit të njëjtën e ka rekomanduar si kandidatë fituese për pozitën “Zyrtar për Shërbime të Punësimit 2” në Agjencinë e Punësimit në Kosovë në Zyrën e Punësimit të Hanit të Elezit sikurse parashihet më nenin 11 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Kështu që referuar gjetjeve dhe konstatimeve si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit në Kosovë, si njësi përgjegjëse, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me rastin e refuzimit të aplikacionit me arsyetimin se ankuesja nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, ngase ka refuzuar aplikacionin vetëm pas konstatimit se ankuesja nuk ka dorëzuar aplikacionin e kompletuar me dokumentet e kërkuara sikurse parashihej në konkurs, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7 dhe 8, ku përcaktohet se: 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve; 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi, ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të këtij Ligji. Rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit të datës 06.12.2024 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën e punës „Zyrtar për Shërbime të Punësimit 2” në Zyrën e Punësimit të Hanit të Elezit -Agjencia e Punësimit në Kosovë, me numër reference RN00015107, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi i datës 12.11.2024 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Njoftimi i datës 06.12.2024 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve, për pozitën e punës „Zyrtar për Shërbime të Punësimit 2” me numër reference RN00015107 në Zyrën e Punësimit në Hanin e Elezit në Agjencinë e Punësimit në Kosovë, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.2079/2024**

**Ylber Fetahaj**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankueses, V.L;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*